



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2018:061024

Datë: 29.10.2020

Numri i dokumentit: 01228046

P. nr. 102/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORENË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga fshati H., Komuna e O., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II. nr. 137/2018, të datës 09.03.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën 26.08.2020, në prezencën e prokurorit të shtetit Mone Sylja, të akuzuarit A. M. së bashku me mbrojtësin e tij A. K. avokat në Malishevë, **më 31 gusht 2020 nxjerr dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.M.**, nga i ati F., e ëma R. e gjinisë M., i lindur më ..., jetoj ne F.- K. Rr. "D." banesat "B.h." kati ... hyrja ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, i martuar, atë i 1 fëmije, ka të kryer shkollën e mesme teknik i mashinerise, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datën 02.01.2018, rreth orës 16:00 h, në aksin rrugor M.- O., saktësisht përball pompës së derivateve "M." në fshatin T., Komuna e Malishevës, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 42 dhe 61, lidhur me nenin 255 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088, dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë edhe pse ka qenë i vetëdijesh se më një veprim të tillë, do të vije deri të pasoja e ndaluar, lehtas ka marrë se gjerë të ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do t'i shmanget, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin "A.-...", ngjyrë hiri metalike, me targa ..., më të arritur të pompa e derivateve "M.", është ndaluar për një moment, parape merr veprim për tu kyçur në rrugën kryesore në drejtim të M., pa u siguruar me parë së mund ta marrë një veprim të tillë, pa i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, si pasoj më të dal në rrugë ia ndërpre në lëvizjen e lirë automjetit "....", ngjyrë të kaltër me targa ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari A. M., që vinte përball, ku në pamundësi t'i shmanget aksidentit, e lëshon shiritin e tij qarkullues dhe del në shiritin e djathtë të rrugës, në pamundësi për tu ndal me pjesën e parë ballore e godet në pjesën e parë të krahut të djathtë automjetin e të pandehurit, më ç 'rast përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të rënda

trupore pëson i dëmtuari A. M., lëndime të konstatuara dhe të përshkruar hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. Sc. F. B., të datës 17.01.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,43,45,46,47,73,74,75,76 dhe 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së dhe 248 e 365 të KPPK-së, të pandehurit **A. M.** i shqipton:

DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ZËVENDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit **A. M.**, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **A. M.**, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) Euro, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej dhjetë (10) muajsh, në këste të barabarta.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë dënimi i zëvendësuar me gjobë do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, shpenzimet e ekspertizës mjeko- ligjore në shumën prej 20,00 €, shpenzimet e ekspertizës së komunikacionit në shumën prej 50, 10 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20, 00 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A. M. nga fshati Ll., Komuna e M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP/II. nr. 137/2018, të datës 09.03.2018, kundër të akuzuarit A. M. nga fshati H., Komuna e O., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 26.08.2020, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin, nuk e kundërshtoj pranimi e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar favorët dhe pasojat

e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim gjen mbështetje edhe ne provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, nga të cilat prova është paraqitur gjendja faktike si ne dispozitiv të aktakuzës, nga i cili dispozitiv formohen të gjitha elementet e veprës penale në të cilën ngarkohet i akuzuari, andaj gjykatës i propozoi i njëjti të shpallët fajtor, të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në shpenzimet e procedurës penale.

Mbrojtësi i te akuzuarit A. M. av. A.K., deklaroi se bazuar ne rrethanat ne te cilat ka ndodhur vepra penale por edhe konsultimin e vazhdueshëm dhe te qarte qe e kam pasur me klientin tim, klienti im e pranon këtë vepër penale njëherë e lusim gjykatën qe ta merr si rrethana lehtësues me rastin e marrjes se dënimit po ashtu me rastin e matjes se dënimit, e lusim gjykatën me mirësi qe ti merr parasysh edhe rrethanat tjera si p: sh, sjelljen e klientit tim, me raport me organet e rendit dhe sigurisë siç është policia dhe gjykatë sjellja korrekte e tij ndaj palës se dëmtuar përfshirë edhe kërkim faljen ne natën e aksidentit ne Qendrën Emergjente në M. menjëherë pas ndodhjes se aksidentit, përfundimisht edhe njëherë e lusim gjykatën sipas mundësisë ligjore te shqipton sanksionin me te bute penale.

I pandehuri A. M., deklarohet i fajshëm për akuzën, është hera e parë që e kam kryer, deklaroj se me te dëmtuarin A. M. jemi pajtuar natën e aksidentit, kërkoj nga gjykata që të më dënoj sa më pak, dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris ndonjë vepër tjetër penale, e njëjta ka ndodhur pa dashjen time. E lus gjykate qe mundësisht te me dënoj me burgim dhe te njëjtën te ma shndërroj me gjobe.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se aj me datë, kohë dhe vend si në diapozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti hetues mbi vend shikimin e aksidentit nr. ER-... dt. 02.01.2018; procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit ER- dt. 03.01.2018; polica e sigurimit “S.” për A. M. nr. nga dt. 11.05.2017-....; deklaratë e A. M. nr. ER-.... dt. 01.01.2018; Qendra Klinike Universitare- Qendra Emergjente për A. M.; Q. K. M. F. M. raporti mjekësor nr. ... dt. 02.01.2018 për A. M.; Q. K. M. F. M. raporti mjekësor nr. ... dt. 02.01.2018 për A. M.; foto dokumentacioni i vendit te ngjarjes; ekspertiza mjeko- ligjore e Prof. Ass. Dr. F. B. MD, FMD, MS, PhD, për A. M. dt. 17.01.2018; ekspertiza e komunikacionit Mr. Inxh. Kom. A. L. dt. 27.01.2018, si dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka aprovuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit **A. M.**, duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **A. M.**, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) €, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej dhjetë (10) muajsh, në këste të barabarta ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e

dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i vihet në barrë, është i moshës së re, e ka kryer për herën e parë, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëritë veprën tjetër penale, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, është mbajtur në familje, andaj gjykata konsideron me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P. nr. 201/18, Datë: 31 gusht 2020

Zyrtarja ligjore,
Albane Morina

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi Morina

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.